



## Procesverbal

I mbajtur në Seancën katërt (IV) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 28.3.2013 me këtë:

### REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**

2/1. Raporti financiar për vitin 2012 i Komunës së Gjilanit,

### 3. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.5 min

Kryesuesi i Kuvendit  
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së katërt morën pjesë:  
Anëtarët e Kuvendit,  
Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa,  
Drejtorët e drejtorive  
Përfaqësuesi i OSB-së, z. Irfan Ukshini  
Përfaqësuesi i OJQ "Anamorava", z. Isa Shefkiu  
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu  
Mediet

Seancën e katërt të KK-së e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, përfaqësuesit e OSB-së dhe të gjithë drejtorët e drejtorive, duke i përfshirë edhe monitoruesit e tjerë të cilët i përcjellin punimet KK-së.

Në vijim kryesuesi i punimeve të seancës kërkoi nga sekretaria që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e kësaj seance.

## 1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,

Pas verifikimit që e bëri sekretaria u konstatua se në punimet e seancës së katërt ish-in të pranishëm 39 anëtarë, kurse munguan 2: Jehonë Hyseni dhe Tefik Ibrahimimi

### Procesverbali

Nuk pati vërejtje në procesverbalin e seancës së dytë dhe të tretë dhe u aprovuan me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

Izmi Zeka- para se të fillojmë me punë po e bëj një njoftim se anëtari i Kuvendit, z. Sami Hoxha, është emëruar drejtor në Gjimnazin “Zenel Hajdini” i cili tërhiqet nga pozita e anëtarit të Kuvendit, kurse në vend të tij do të vijë anëtari tjetër sipas radhës. Sami Hoxha, këto ditë i ka mbushur plotë 10 vjet që ka qenë anëtar i KK-së, do të thotë ka qenë pjesë e Kuvendit që nga themelimi i këtij institucioni.

Z. Hoxha ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen e dhe formimin e institucioneve të lira dhe demokratike në Gjilan. Gjithashtu z. Hoxha, ka qenë një shembull për qytetarët e Gjilanit, sepse të gjithë e njohin për angazhimin e tij për punën dhe korrektësinë e tij dhe për kontributin që ka dhënë që ne sot gjendemi këtu. Një dekadë angazhim në KK, ka qenë privilegj edhe për Samiun, por ka qenë një privilegj edhe për neve qytetarëve të Gjilanit, Administratën Komunale dhe për neve kuvendarëve.

E falënderojmë, z. Samiun për kontributin e tij në të gjitha sferat e jetës, duke i uruar shëndet dhe rezultate në punë dhe dëshirojmë që të kontributi i tij të jetë ashtu siç ka qenë në KK të Gjilanit të jetë edhe në institucionin arsimor në të cilin është emëruar. Suksese dhe shëndet në emër të Kuvendit i urojmë, z. Sami Hoxhës, por para se ta merr fjalën z. Sami Hoxha, unë e thërras që t’ia ndajmë një mirënjohje si simbolikë për kontributin që i ka dhënë KK-së.

I epet mirënjohja. Z. Sami Hoxhës të cilën ceremoni anëtarët e Kuvendit e duartrokasim.

Sami Hoxha- i nderuari, kryesues i Kuvendit, e nderuara kryesi e Kuvendit, të nderuar kuvendarë dhe të gjithë mysafirë dhe monitorues të pranishëm, unë sot nuk po i largohem përgjegjësive, por për shkak të obligimeve ligjore jam i detyruar që të jap dorëheqje dhe për këtë arsyeje dua ta respektoj rendin dhe ligjin.

Unë e kam marrë një përgjegjësi të re, por edhe me këtë përgjegjësi mendoj për ta vazhduar bashkëpunimin me ju në vazhdimësi, sepse aty ku jam tash në Gjimnazin “Zenel Hajdini” kemi nevojë për ndihmën e të gjithëve.

Për mua është një kënaqësi e veçantë, sepse nga kjo foltore kemi debatuar dhe diskutuar për 10 vjet rresht. Kemi marrë me qindra vendime në këtë Kuvend dhe të gjitha ato vendime kanë qenë në interesin e qytetarëve dhe Komunës së Gjilanit.

Ka qenë një bashkëpunim shumë i sigurtë, shumë profesional me të gjithë anëtarët e Kuvendit. Unë e kujtoj seancën e parë të këtij Kuvendi së bashku me anëtarin e grupit të LDK-së, z. Jakup Bajrami e cila seancë është mbajtur pas zgjedhjeve të para të lira dhe demokratike e cila është mbajtur me ë datën 11. 11. të vitit 2000, ora 11.

Do të thotë ka qenë datë karakteristike dhe të gjitha i kemi pasur të shënuara.

Në këtë rast unë shprehi vullnetin edhe pse nuk jam pjesë e Kuvendit, unë jam pjesë e juaja dhe ju jeni pjesë me mua dhe do të rrugëtojmë së bashku në ngritje të institucioneve të shtetit të Kosovës.

Ju faleminderit për një bashkëpunim shumë të sigurtë dhe iu uroj shëndet dhe suksese në punën e juaj !

Izmi Zeka- pas fjalës së z. Samiut, kalojmë në rendin e punës, por më duhet të theksoj se herën e kaluar e kemi bërë bartjen e disa mjeteve financiare, por për shkak të disa ndryshimeve dhe kodeve në MEF, duhet një aprovim formal që këto mjete të barten në kode të tjera. Në rend punë është Raporti financiar i viti 2012 dhe nën 2. bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të viti fiskal 2011 dhe 2012 në vitin fiskal 2013.

Kush është për këtë rend pune?

Aprovohet rendi i punës me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit

## **2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**

### **2/1. Raporti financiar për vitin 2012 i Komunës së Gjilanit,**

Izmi Zeka- unë lidhur me raportin, fjalën ia barti drejtorit për Financa që shkurtimisht të na i ep disa sqarime, pasi që anëtarët e Kuvendit e kanë marrë raportin me shkrim dhe ata do ta kenë fjalën për të dhënë vërejtje dhe bërë pyetje, apo dhënë edhe ndonjë sugjerim.

Nuhi Nuhiu- drejtori i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe theksoi se në këtë seancë është për diskutim vetëm raporti financiar për vitin 2012 dhe një pikë e cila vetëm duhet formalizuar. Ky është një raport i cili paraqet punën e Qeverisë Komunale të Gjilanit, por së pari e kam një njoftim se dje në shtyp ka dalë një informatë në të cilin ka qenë një gabim nga Zyra e Informimit, sepse aty thuhet 640 mijë €, kanë mbet obligime të pakryera të vitit 2012 dhe jo si i paraqet raporti financiar 3 milion 290 mijë €. Ky ka qenë një gabim i paqëllimshëm dhe unë nuk e kam dhënë atë informatë, por në mbledhje të takimit të drejtorëve është marrë në atë formë. Nuk qëndron ajo se i kemi obligime 640 mijë €, por është shuma e cila gjendet në raport.

Ne edhe kur e kemi planifikuar buxhetin e kemi thënë se nuk është një buxhet i duhur për zhvillimin e një komune, por ne ka qenë desh në suaza të këtij buxheti të operojmë, të menaxhojmë dhe në fund të dalim me një pasqyrë reale financiare.

Raporti i paraqet të gjitha aktivitetet të cilat janë zhvilluar në Komunë të Gjilanit i cili është i saktë, është transparent dhe asgjë nuk ka të fshehur pas këtij raporti, sepse çdo faturë dhe çdo pagesë e bërë është e paraqitur në raport.

Në fillim kur është bërë planifikimi i buxhetit ka qenë 17 milion e 667 mijë e 78 € dhe aty janë kategoritë e shpenzimeve dhe nga ky buxhet 64% kanë qenë për paga dhe mëditje, 9.86 % për mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, 2.15%, subvencione 1.41% dhe investime kapitale 21.4%.

Buxheti përfundimtar ka qenë 19 milion 108 mijë e 957 €. Këto mjete mund të shihen në tabelën numër 5 se si janë shpenzuar dhe ku janë shpenzuar?

Në vijim të fjalës së tij drejtori dha edhe shumë hollësi të tjera lidhur me këtë raport të cilin raport të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë marrë me kohë.

Zijdin Maliqi- unë do të mundohem t' i jap disa vërejtje në vija të trasha për këtë raport, kurse për detale të tjera do të kenë hapësirë edhe kolegët e tjerë për të dhënë vërejtje. Të hyrat shihet në bazë të tabelave se janë në kuadër të atyre të planifikuara, me një shmangje të vogël prej 3.5%.

Nëpër kategori të të hyrave kemi diku ngritje të të hyrave, diku rënie të cilat nuk janë të mëdha me përjashtim të dy kategorive, si është të gjobave në trafik, ku kemi zbritje

të madhe, por për këtë u dhanë sqarime nga drejtori, por është edhe një ngritje shumë e madhe është te kategoria te të hyrat për leje për punë! Kjo kategori te të hyrat për leje për punë për mua është e paqartë dhe nuk e di pse është kjo shumë mbi 56 mijë €. ? Kjo dihet se në rregullore mbi tarifatat dhe ngarkesat paguhet 10 euro për një leje pune! Në bazë të këtij raporti del se Komuna i ka dhënë 5675 leje për punë! Sikur të gjitha bizneset të kishin marrë leje për operim gjatë këtij viti, aq nuk i ka Komuna e Gjilanit. Për këtë është mirë që drejtoria të na ep një sqarim se si ka ndodhur dhe ka ardhur deri te ky fakt?

Sa i përket krahasimit të buxhetit të realizuar me 2011, shihet se kemi ngecje diku afër 9% nëpër disa kategori, por edhe buxheti i vitit 2012 ka qenë i planifikuar më i vogël, se sa buxheti i vitit 2011.

Te shpenzimet dhe nga tabela e shpenzimeve që i ka paraqitur drejtoria shihet se kategoria e mallrave dhe shërbimeve është në kuadër të shpenzimeve të planifikuara.

Mirëpo nëse e marrim edhe pjesën tjetër të shpenzimeve të krijuara të papaguara e të cilat janë bartë në vitin 2013 e ku është një shumë bukur e madhe prej 1 milion e 365 mijë €, atëherë del se te mallrat dhe shërbimet kemi shpenzime shumë, shumë më të mëdha se ato të planifikuara dhe arrin në 53% më tepër se të planifikuarat.

Është desh që ta kemi pasqyrën e obligimeve sipas kodeve buxhetore, jo në mënyrë analitike, shpenzim për shpenzim, por sipas kodeve buxhetore për të pasur mundësi për ta pasur një pasqyrë dhe analizë më të mirë të këtyre shpenzimeve.

Nga ato që i kemi në raport te shpenzimet për mallra dhe shërbime shihet se nëpër disa kode buxhetore ende vazhdohet me shpenzime të mëdha. Ne këto gjëra i kemi përmendur edhe gjatë raporteve periodike dhe përfundimtare dhe kemi theksuar se për neve në disa kode buxhetore janë duke u bërë shpenzime të mëdha, prej të cilave po i theksoj disa për pa hyrë në hollësi, siç janë;

Shpenzimet jashtë vendit ku përfshihen akomodimet dhe mëditjet, ku ka shpenzime bukur të mëdha! “Vala 900”, përsëri kemi shpenzime të mëdha, por këtë vit janë rritur edhe më shumë edhe pse çmimi i Valës është duke zbritur, kurse shpenzimet po rriten. Mirëpo në këto shpenzime ka edhe dallime shumë të mëdha nga një drejtori në drejtorinë tjetër dhe kemi shpenzime prej 66 €, deri në 240 €, por Drejtoria për Urbanizëm ka bërë shpenzime vetëm 30 € për një muaj për Valën 900.

Furnizimet për zyre mendoj se janë mjaft të mëdha, por po e vërej edhe një tendencë të rritjes prej vitit në vit dhe shpenzime të tilla kemi 233 mijë €.

Derivatet për vetura, gjithashtu, janë të mëdha.

Mirëmbajtja dhe riparimi i veturave edhe pse janë blerë vetura të reja, kjo vlerë është duke shkuar në rritje.

Te drekat zyrtare në krahasim me vitin paraprak është një rënie, por kur e shikojmë kodin tjetër ushqim dhe pije ajo është në rritje. I përjashtoj ato që janë për Drejtorinë e Arsimit, Arsimin Parashkollor, Konviktin, kurse të tjerat hyjnë te kodi i drekave zyrtare.

Edhe te kjo kategori ushqim dhe pije kemi dallime të mëdha nga drejtoria në drejtori, sepse kemi drejtori e cila i ka shpenzuar deri në 4 mijë € për këtë qëllim me para të gatshme (petikesh). Mirëpo edhe këtu është shembull DUMM e cila e ka kaluar tërë vitin me 180€ .

Sa i përket investimeve kapitale në bazë të pasqyrave në raport shihet se kemi një realizim prej 93%, por ne mbrëmë kemi marrë një pasqyrë nga Zyra e Prokurimit për investime kapitale dhe aty e kemi parë gjendjen e Komunës sa i përket investimeve kapitale. Në bazë të pasqyrave ka të dhëna që janë disa rrugë 3 mijë, 4 mijë euro e të cilat janë asfaltuar me këtë sasi të mjeteve. Unë nuk e kam të qartë se si mund të bëhet kjo? Në bazë të kësaj pasqyre shihet se Komuna ka ngel shumë në këtë aspekt!

Kemi projekte të cilat kanë filluar në vitin 2009 dhe sot e asaj dite janë të papërfunduara. Kjo është e pafalshme, është shkelje e ligjit, por unë e di se kryetari do të ep përgjigje se projektet përfundohen për disa vite, por dihet se cilat projekte bëhen për disa vite? Mua më duket se më shpejtë do të përfundojë autostrada Morinë-Merdare se sa rruga "Halim Orana" e cila nuk i kam më shumë se 500m. Kjo është një gjendje e rëndë dhe ne këto gjëra i kemi përmendur edhe më herët siç është rasti te Teqeja e qytetit, kur për disa rrugë në 2009 është bërë kontrata, por është shtrirë vetëm zhavorr dhe deri më sot janë të papërfunduara dhe gjendja e tyre është shumë e rëndë.

Mirëpo ajo më brengosëse janë borxhet e Komunës! Janë borxhet të cilat janë bartur nga viti 2012 në vitin 2013. Ne i referohemi raportit financiar dhe jo asaj se çka shkruan në shtyp, sepse dikush po i dezinformon qytetarët për të cilin rast drejtori dha sqarime se sa janë borxhet e Komunës. Borxhet janë shumë të mëdha dhe unë kam frikë që këtë vit, borxhet nuk do të zvogëlohen, sepse në vitin 2012 janë rritur kategoria e mallrave dhe shërbimeve diku rreth 30%, kurse unë kam pritur se do të zvogëlohen ato, por përkundrazi kemi rritje të madhe 1 milion e 365 mijë euro janë vetëm për mallra dhe shërbime. Komunalit, nuk e di si kanë mbetur, por mund të bëhet një planifikim më i mirë, sepse janë rreth 200 mijë euro.

Te investimet kapitale në total janë borxhe 3 milion e 291 mijë euro. Këto janë të pafalshme dhe për mua këto janë anashkalim i ligjeve që rregullojnë fushat e caktuara të financave si Ligji i prokurimit, menaxhimit të financave dhe financat e pushteti lokal. Unë me keqardhje po them si njohës deri në njëfarë mase i këtyre gjërave, nuk e kam guximin të kërkoj nga grupi i anëtarëve tonë që ta aprovojë këtë raport!

Me këto borxhe, me këto shkelje edhe sikur unë të kisha qenë në pushtet, betohem se personalisht do të kisha votuar kundër këtij buxheti.

Sokol Haziri- së pari e kam një përshëndetje të veçantë për kolegun tonë Samiun i cili sot definistivisht po largohet nga Kuvendi të cilit u urojmë shëndet të mirë dhe suksese në obligimet dhe detyrën e re.

Sa i përket rendit të punës dhe ne parimisht e mbajmë të njëjtin qëndrim si AKK ashtu sikur kur është miratuar buxheti në vitin 2012. Ky ka qenë një buxhet i ripërtrijes së jetës, një buxhet i varfërisë dhe jo një buxhet i investimeve. Këtë e kemi thënë dhe po e them përsëri se kjo është jo me fajin e tërë të Komunës, por me pakujdesin nga Qeverisja Qendrore për Anamoravën dhe Gjilanin në veçanti. Kjo është një dukuri tepër e rëndë për këtë segment, sepse ne e dimë se buxheti i Kosovës kryesisht mbushet nga të hyrat doganore dhe të hyrat tjera. Sido që të jetë me këto kapacitete që kanë ekzistuar të mjeteve financiare, mendoj se është tentuar që të ketë një destinim të duhur të buxhetit, por nuk është ajo që e kërkojmë dhe dëshirojmë të gjithë së bashku këtu duke e përfshirë edhe kryetarin e Komunës. Drejtori sot e paraqiti pasqyrën e të dalave të buxheti, pasqyrën se si janë shpenzuar mjetet e taksapaguesve të Komunës dhe më gjerë, por politikën e bën kryetari dhe partitë politike që janë në pushtet në Gjilan.

Sido që të jetë ne i mbështesim vërejtjet që u dëgjuan nga kolegu im nga opozita (një pjesë të konsiderueshme të tyre), jo të gjitha duke kërkuar sqarime nga drejtori i Financave lidhur me borxhet që po barten nga viti në vit. Ne dhe në seancën e kaluar kemi pas kërkuar që borxhet të jenë të specifikuar dhe të dihet konkretisht se kujt Komuna i ka borxh dhe sa i ka borxh? Tema e borxheve është bërë një temë e cila ndoshta edhe stërmadhohet edhe shtrembërohet, prandaj për këtë kërkojmë që të kemi pasqyrë konkrete se cilave kompani i kemi borxh dhe për sa kohë është krijuar ai borxh?

Kjo është kërkesa ime dhe kjo të specifikohet qartë! Mirëpo edhe një obligim që do të duhej të ishte publik lidhur me atë se kur mund të përmbushen obligimet ndaj këtyre kompanive. Në parim lidhur me raportin janë këto qëndrime dhe në fund po i jap disa sugjerime për të ardhmen. Mendoj se raportit do të duhej t' i bashkëngjiten edhe raportet e auditorëve të përgjithshëm dhe të brendshëm për ta ditur ne si anëtarë të Kuvendit se si ata e kanë vlerësuar menaxhimin e mjeteve nga Komuna?

E dyta ajo që u tha në lidhje me shpenzimet të telefonisë mobile, karburanteve, udhëtimeve jashtë vendit të kihet kujdes pak më tepër dhe këto të ulen në shkallën e tolerueshme dhe këto mjete të dedikohen për investime kapitale ose çështje sociale që janë mjaft të mëdha në Komunë.

Ne dhe më herët kemi thënë se një shtrirje nuk duket shumë përfshirëse në Komunë dhe propozojmë që në të ardhmen të jetë shtrirja e investimeve të jetë më e gjerë me këto kapacitete që i kemi, sepse nuk mund të bëjmë mrekulli me këto mjete, por duhet të shihet kujdesi i pushtetit ndaj qytetarëve kudo që janë, pavarësisht përkatësisë partiake të atij mjedisi.

Këto janë disa opinione për AAK-në, por lidhur me aprovimin e raportit nuk do të deklarohej derisa nuk i marrim sqarimet lidhur me atë se si do të epen përgjigjet në pyetjet dhe sugjerimet tona.

Arben Mehmeti- neve këtu na është shpërndarë në revistë, por lidhur me këtë kemi vërejtje sa i përket shpenzimeve, botimeve, marketingut dhe fushës së informimit.

Këtë fletushkë që na e keni ofruar për neve është e papranueshme si LDK, sepse kësaj mund t' ia ndërroni logon dhe të bëni PDK dhe t' ia jepni aktivistëve të juaj politikë.

Herëve tjera nuk është mirë të sillini këso gjëra dhe ta informoni kështu opinionin.

Kërkojmë nga drejtori i Financave në emër të grupit kuvendar të LDK-së që të na ofrojë të gjitha shënimet e hollësishme lidhur me këto shpenzime. Të jetë kjo kërkesë zyrtare dhe mos pritni dokumente tjera shtesë, sepse ne kemi dorëzuar dokumente më herët, kemi kërkuar sqarime dhe specifikime lidhur me shpenzimet, mirëpo ato nuk na janë ofruar! Konsiderojmë se këtu është vendi adekuat për t' i kërkuar këto shpenzime detale për të gjitha këto shpenzime të cilat janë bërë në komunën e Gjilanit.

Të jetë e qartë shpenzimet detaje për të gjitha shpenzimet që janë bërë në vitin 2012.

Nga një dokument që na e keni ofruar shihet se Gjilani është në krizë të madhe të zhvillimit ekonomik dhe shihet se në vitin 2012 kanë qenë 4 projekte, kurse në vitin 2013 është rrezik që mos të jetë asnjë projekt. Çdo vit ka rënie dhe ne faktikisht e kemi përmend se Gjilani është me një zonë të mbyllur që ka mbetur e anashkaluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ato mjete që i harxhon Komuna e Gjilanit ato përdoren për kryerjen e obligimeve në raport me operatorët ekonomik të cilët kanë operuar në Komunën e Gjilanit. Nga lista e projekteve që i keni realizuar unë kërkoj që zyrtarisht të na informoni mbi procedurat, për formën e lidhjes së kontratave dhe me pasojat e mos realizimit të punëve në bazë të kontratës. Shihet se kemi kontrata që nga viti 2009 dhe po ashtu kemi obligime për punë të kryera janë zero. Kjo të jetë për Zyrën për Prokurim, prandaj kërkoj shpjegim zyrtar pasi që në seancë është edhe ish drejtoresha e Zyrës së Prokurimit e cila duhet të na informojë më hollësisht.

Projektet si janë: asfaltimi i rrugës në fshatin Livoç i Ulët, vlera e kontraktuar 320 mijë €, ndërsa vlera e realizuar 241 mijë €, kurse obligimet për punët e kryera është zero.

Në vitin 2009 është nënshkruar kontrata, jemi në vitin 2013, prandaj ne i kemi disa njohuri se kontratat kur nënshkruhen i kanë edhe afatet e realizimit. Në këtë rast po pyes kush duhet të jep llogari dhe cila është forma e sanksionimit të operatorëve në qoftë se nuk kryen obligimet ashtu si kërkohet me kontratë?

Unë po kërkoj për të gjitha obligimet që janë zero-zero që janë në raportin zyrtar e që projektet kanë filluar që nga viti 2009, 2010, 2011, kurse në vitin 2012 janë vetëm 4 projekte. Me Ligjin mbi prokurimin publik janë afatet kohore, me Ligjin mbi financat publike, janë afatet e pagesave për punët e kryera dhe po ashtu edhe me Ligjin për thesarin rregullohen edhe procedurat e pagesave. Këto obligime janë zero-zero, kur është nënshkruar kontrata me operatorë lidhur me projektet e ndryshme dhe nga ajo që na është ofruar këtu iu ka lënë në vullnetin e lirë operatorëve ekonomik aq sa mund të kryejnë punë, aq e bënë një pagesë Komuna për pa i llogaritur veprimet tjera të cilat duhet për t' i ndërmarrë. Kontrata kur nënshkruhet është i paraparë edhe dënimi në rast se nuk është realizuar kontrata ashtu si është nënshkruar.

Në këtë rast kërkoj nga Zyra e Prokurimit që hollësisht të na informojë për këto projekte që i kemi në tavolinat tona dhe për obligimet që janë zero-zero, kurse në praktikë ne e vërejmë se është krejt ndryshe nga ajo që është raportuar këtu.

A është nën vullnetin e lirë të Zyrës së Prokurimit dhe Komunës së Gjilanit që t' ia lënë hapësirën operatorëve ekonomik që aq sa mund të kryejnë punë, aq le të kryejnë dhe aq sa është mundësia Komuna t' i kryejë obligime financiare aq le t' kryejnë dhe për pa u brengos fare për afatin ligjor të realizimit të kontratave sipas ligjeve në fuqi.

Sadudin Berisha- kur të bisedohet dhe merret një qëndrim nga pozicioni i grupimit politik për një raport financiar për një vit kalendarik, kujtoj se duhet nxjerr një konkludim se çfarë ka qenë nikoqiri i shtëpisë gjatë një viti kalendarik, cilat kanë qenë përgjegjësitë e tij dhe si janë realizuar?

Nëse kemi një obligim mbi milion €, obligime të arritura dhe të pakryera dhe të papërfunduara, kjo ka të bëjë me një vit buxhet financiar buxhet të Komunës nga të hyrat vetanake. Jemi për një vit borxh, ndaj operatorëve, ndaj të cilëve kemi obligime të kontraktuara, që do të thotë një vit i obligimeve vetanake buxhetore duhet të shfrytëzohet për vitet e mëparshme. Kur them për vitet e mëparshme, kemi të bëjmë prej vitit 2009 deri në vitin 2012, kjo do të thotë 4 vite të plota.

Për mua gjithashtu është shqetësuese që kemi kërkuar në KPF, se kjo përgjigje është e pjesërishme nga ajo që kemi kërkuar. U tha se duhet të na ofrohen kontratat me datën e lidhjes dhe datën e përmbylljes së obligimeve të kontraktuara. Ne e kemi këtu datën e lidhjes së kontratës, por jo edhe të datës kur është dashur obligimet e kontraktuara të përmbyllen. Këtu nuk e dimë se e kujt është përgjegjësia, a është e kontraktuesit të parë që është KK, apo i kontraktuesit të dytë e që është punë kryesi?

Nga kjo ne konstatojmë se përgjegjësia është e dyanshme. I kemi dy pasqyrat e fundit, borxhet e arritura të papaguara me punët e kryera diku me 660 mijë €, përderisa kemi të kontraktuara borxhe jo, 3 milion e 200 mijë, por 5 milion e 121 mijë €, duke e llogaritur dhe rregullimin shtratit të Lumit Mirusha. Nga kjo që u tha do të thotë punë të kontraktuara, kemi kaq punë të përmbyllura, varësisht nga periudha e që nuk janë paguar, janë 664 mijë €, borxh i Komunës. Mirëpo ne sërish nuk mund të konstatojmë se përgjegjësia e kujt është, a është mungesa e parasë nga kontratat e lidhura nga KK, përkatësisht kryetari i Komunës i cili menaxhon me këtë buxhet apo e punë kryesit?

Nëse është e punë kryesit, Komuna do të duhet që të ngrit procedura gjyqësore për realizimin e obligimeve ndaj kontraktuesit të dytë (punë kryesit). Asnjë rast nuk e kemi se ka ndodhur diçka e tillë? Për këtë arsyeje kjo informatë është për manipulim, është një informatë për ta përvetësuar politikisht këtë situatë që vërtetë është e mjerë financiarisht në KK të Gjilanit dhe thjeshtë ky vit do të jetë jashtëzakonisht i zbehtë, vit i cili të gjitha taksat komunale të qytetarëve do të derdhen ndaj obligimeve që Komuna i ka borxh. Për këtë arsyeje, kërkoj që sa më parë Zyra e Prokurimit e ekzekuton atë që i epet urdhëresa. Kërkojmë që sa më parë të na epet lista e

kontraktuesve nga viti 2009 të plotë me afate të lidhjes së kontratave, të afateve të kryerjes së obligimeve, të borxheve të paguara dhe të atyre të perealizuara?

Vërtetë kemi të bëjmë me një obligim shumë të madh. Drejtori e tha se e ka realizuar një borxh në tre mujorin e parë, por ai buxhet është i këtij viti, me të cilin po i kryejmë obligimet e viteve të mëparshme.

Për këtë arsyeje kërkoj nga kryetari i Komunës që të na përcillet pasqyra e saktë e kontratave të lidhura me afatet e kontraktuara, të borxheve të paguara dhe të papaguara, punët e kryera dhe ato të cilat nuk janë realizuar?

Abdyl Aliu- unë do t' i theksoja projektet e financuara nga grand i për vitin 2012. Në listën e projekteve të financuara nga ky grand i pari prin asfaltimi i rrugës në “Zabelin e Sahit Agës” me një vlerë diku 95 mijë €. Kjo fare nuk është e vërtetë dhe lista fillon me një të pa vërtetë! Po e them me përgjegjësi të plotë edhe materiale edhe morale se në “Zabelin e Sahit Agës” nuk është hedh asnjë lopatë e vetme asfalt. Unë jam prej kësaj lagjeje dhe këtë e di mirë. Është një asfalt në Kuscën e Poshtme, ndoshta është menduar për atë, por Kusca e Poshtme nuk është “Zabeli i Sahit Agës”?

Në listën e projekteve është edhe një projekt për “Zabelin e Sahit Agës” dhe thotë kështu: ‘rregullimi i kanalizimit të Qendra e Arsimit Profesional, lagjja “ 7 Korriku”. “Zabeli i Sahit Agës” Malisheva, si dhe rregullimi i ujësjellësit në Lagjen e Tetë. Të gjitha këto projekte e kanë vlerën 4 mijë € ! A mund të merret me mend kjo? Nëse këtë shumë e pjesëtojmë për pesë projekte del se 800 €, është një projekt! Po e përsëris a mund të kryhet një kanalizim me 800 € në “Zabelin e Sahit Agës” ? Kjo për mua është shaka e ditës, sepse kjo nuk ka ndodhur në lagjeje. E tëra çka ka ndodhur në këtë lagjeje është një kontrabandim me tokën që është bërë e që këtu në Kuvend e kemi stopuar. Të gjitha këto projekte të cilat janë këtu, janë vetëm një tentim për t' i mashtruar banorët e lagjes së Zabelit të Sahit Agës! Lista e projekteve të financuara nga grand i, Malisheva e kryetarit ka përfutur diku 420 mijë euro projekte të ndryshme. Zabeli i Sahit Agës, zero investime. Nuk e kam të qartë pse është ky diskriminim?

Mandej është fasadimi i objekteve me banim kolektiv dhe riparime të nevojshme në soliter. Riparimet kanë ndodhur para se të bëhej fasadimi, sepse nuk mund të bëhet njëherë fasadimi, pastaj riparimi! Riparimi është bërë në vitin 2011, kurse në vitin 2012, janë heq vetëm skelet, sepse kanë qëndruar një kohë të gjatë aty. Në soliter janë bërë edhe disa renovime diku afër 70 mijë euro janë investuar atje, por shtrohet pyetja cila është gjendja sot në atë soliter? Ky projekt nuk ka qëndruar fare dhe ka kushtuar shumë, kurse nga të reshurat depërton uji. Puna është bërë jo profesionale, por edhe mbikëqyrja gjithashtu ka qenë jo profesionale. Banorët e soliterit kanë ushtruar padi me fotografi për gjendjen aktuale në Drejtorin për Shërbime Publike, por askush deri më sot nuk iu ka dal zot dhe nuk iu është dhënë përgjigje.

Madje është sanimi i shtratit të Lumit Mirusha mbi 16 mijë euro, do të thotë është sanuar pasi është rregulluar. Nëse është rregulluar, pse të bëhet pagesë për sanim?

Unë kërkoj një raport të plotë të aktiviteteve të prokurimit të KK- Gjilanit për vitin 2012, duke i pasqyruar shpenzimet e karburanteve dhe mirëmbajtjes së parimit të veturave, por e kërkoj edhe një raport nga Autoparku. Raport nga Autoparku me të gjitha të dhënat, duke i përfshirë numrin e km. për çdo veturë, sasinë e harxhuar të karburanteve ? Këtë e kërkoj, sepse ka pasur raste kur një automjet i ka shpenzuar 36 litra karburant për 100 km.

Nevzad Rushiti- në këtë raport të cilin po e diskutojmë sot dhe i cili është hartuar nga Qeveria Komonale e Gjilanit, të gjithë të pranishmit, por edhe qytetarët e Gjilanit e kanë vërejtur se Komuna e Gjilanit nuk e ka realizuar atë që e ka premtuar.



Në raport thuhet projekte të mëdha, por unë këtë vit nuk kam parë projekte të mëdha, kurse ato projekte të cilat janë bërë, nuk janë realizuar si duhet dhe si është në projekt dhe rregullore. A është faji i Komunës apo i operatorit në terren duhet të dihet?

Në përgjithësi zhvillim në Komunë të Gjilanit nuk ka, nuk ka ndonjë infrastrukturë tjetër të madhe, por janë bërë vetëm disa riparime, trotuare jo kualitative dhe që mbetën në gjysmë, kurse për ato harxhohen mjete shumë.

Si shembull është trotuari në rrugën "Mulla Idrisi" ku është duke u punuar një kohë të gjatë dhe nuk është bërë asgjë. Gjithashtu edhe projekti i Lumit Banja i cili është projekt i qëlluar, por punët nuk janë bërë, ato kanë mbetur në gjysmë dhe është vështirë për të kaluar edhe këmbë, kurse për automjete as që bëhet fjalë!

Në rrugën Qarkore është bërë një trotuar me grande tona, por ai është shkatërruar, atë shkatërrim e kanë bërë operatorët e tjerë i cili ka mbet ashtu dhe nuk kujdeset më askush për atë trotuar?

Te shumë raporte të realizuara dhe të perealizuara në këtë raport drejtori e jep raportin, por drejtori nuk e dinë si kryhen punët në terren, sepse shumë projekte zhagitën që nga viti 2009 dhe ende nuk kanë përfunduar? Nuk është mirë që tri vite radhas të përsëriten këto projekte dhe i shembull i tillë është fshati Kosaq ku kam qenë sot, ku ende rruga është e tërë me gropa dhe zhavorr dhe nuk ka asfalt, kurse në raport thuhet se në Kosaq të Epërme rruga është asfaltuar!

Rruga "Halim Orana" deri te Fakulteti "Fama" ka tri vite që është duke u punuar, por ka plotë të thëna se është kryer, mandej nuk është kryer, kurse tash shihet se tash është duke u punuar diçka.

Mandej lagjja "Dheu i Bardhë" në këtë mandat është tejkaluar në tërësi, nuk është realizuar asnjë kontratë dhe nuk është paguar asnjë euro. Qytetarët e kësaj lagjeje çdo infrastrukturë e kanë bërë me mjete të veta, si është rruga "Agim Rashiti" i cili projekt ka qenë para 10 viteve dhe ka mbetur ashtu e parregulluar. Mirëpo në këtë gjendje ka edhe plotë rrugë të tjera e të cilat janë brenda unazës së qytetit.

Nuk duhet Qeveria Komunale të bëjë projekte sipas përkatësive partiake, sepse të gjithë banorët duhet të jenë të barabartë.

Unë jam në dijeni se as kryetari dhe askush nuk guxon të nënshkruajë kontrata për pa i pasur mjetet. Po shihen si kanë mbetur objektet të cilat i ka premtuar Qeveria, si gjyqi, policia, biblioteka etj. Duhet pasur kujdes dhe duhet caktuar ekipet për mbikëqyrje të objekteve të filluara dhe të kryhen të gjitha projektet sipas parashikimeve dhe me cilësi të duhur.

Bahrie Veseli- së pari e përshëndesim gjestin e z. Sami Hoxha të cilin gjest duhet ta ndjek edhe kryesuesi, sepse edhe është zv/ministër edhe kryeses i Kuvendit, prandaj është mirë që ta respektoni ligjin.

U thanë shumë gjëra nga parafolësit, por unë dua të di më shumë lidhur me shpenzimet te shërbimet dhe mallrat mendoj se është një shpenzim i tepërt dhe do të ishte mirë që sasi aq e madhe e mjeteve mos të dedikohen vetëm për mallra dhe shërbime. P.sh tek Administrata e Komunës i kemi 40% mjete të harxhuara për mallra dhe shërbime, mandej te Zyra e Prokurimit i kemi 50% mallra dhe shërbime. E njëjta gjë është edhe te Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim 45% mjete të shpenzuara për të njëjtin qëllim.

Mandej te DKA janë harxhuar 63% për mallra dhe shërbime, kurse në shkollën ku punoj mjete të konkretizimit nuk ka, kurse as që bëhet fjalë për sallë të edukatës fizike, kurse nxënësit me mjete personale i blejnë edhe topat për të luajtur. Është mirë që këto shpenzime të bëhen në mënyrë më racionale herëve të tjera.

Mirëpo te arsimit fillor mallra dhe shërbime janë vetëm 4% dhe kjo është në tërësi në kundërshtim me atë që duhet të punohet.

Ne kemi dorëzuar shumë kërkesa, por unë nuk e vërejt se është realizuar ndonjë projekt në Lagjen “Arbëria” edhe pse është një lagje qysh moti e urbanizuar. Ne e kemi bërë një kërkesë qysh moti që rruga që kalon përmes lagjes të asfaltohet, sepse ende është e paasfaltuar. Sa i përket projekteve po vërej se ato i ka përfituar kryesisht “Bejta Comerece”, “Magjistranja”, “Euro-Trans”, por dua ta di se a ka Gjilani edhe tjera kompani të cilat konkurrojnë për realizim të projekteve?

Gjithashtu herën e kaluar kam bërë një pyetje lidhur me kioskën e cili është vendos në oborrin e Shkollës “Abaz Ajeti”, por ende nuk kemi përgjigje. Kërkoj ta di se kush e ka dhënë atë leje dhe afatet e kontratave t’i dimë dhe ta dimë se ka operatorë të cilët nuk i kanë përfunduar punët e veta me kohë dhe që është dënuar për shkelje të ligjit? Duhet të kemi kujdes për shpenzime të telefonisë mobile dhe keqpërdorimit të veturave, sepse jemi dëshmitar se çdo ditë veturat zyrtare shfrytëzohen për transport të familjarëve.

Të na sillen të dhënat sa punëtorë janë me kontratë në vepër dhe mënyrën se si po paguhen?

Ejup Haziri- unë desha të lidhem me një reagim të vogël që u dëgjua për këshilltarët e grupit të PDK-së, por unë jam në fund të mandatit të dytë dhe unë e kam vërejt se në Kuvend janë dy fusha të veprimit, sepse këtu ka leksione praktike dhe teorike.

Realisht këshilltarët e PDK, aktualisht janë në fushën e veprimit praktik, kurse në teori rinë ata të opozitës!

Ramiz Ramdani- nga raporti shihet se buxheti është shpenzuar kryesisht në paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime. Këto dy kategori e marrin pjesën më të madhe të këtij buxheti, mirëpo gjithashtu vërehet një ulje drastike e subvencionit 1.51%.

Vlerësoj se kategoria e cila subvencionohet është në gjendje të mjerueshme dhe në vend të përkrahjes të kësaj kategorie, kemi një rritje të paarsyeshme dhe jo racionale të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Nuk po i përmendi drejtoritë, por kryesisht janë ato drejtori që i përmendi znj. Bahrie e të cilat kanë pasur ngritje enorme në këtë kategori.. Tek shpenzimet analitike sipas kodeve vërehen shpenzime shumë të mëdha të telefonisë dhe shpenzimet e telefonisë fikse janë mbi 34 mijë €, kurse shpenzimet e Valës 900, janë mbi 25 mijë €, e që në total del mbi 64 mijë € e që konsideroj se janë jashtëzakonisht shumë. Te shpenzimet e Valës 900, vërehen dy kategori të shpenzimeve. Shpenzuesit e mëdhenj, aty ku bëhet politika, te Zyra e Kryetarit mbi 7 mijë €, Inspeksioni mbi 3 mijë e 300 €, Bujqësia, mbi 290 €, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim 2 mijë e 250 € dhe Shërbimet Publike 2 mijë e 150 €.

Shpenzuesit racional kanë qenë Drejtoria e Urbanizmit 350, DKRS,450 €, ajo për Gjeodezi 540 €. Një shpenzim enormë është ai për lëndë djegëse ( dru), sepse shpenzohen në këtë kategori mbi 157 mijë € e që në fakt janë mbi 4 mijë m<sup>3</sup> dru. Mirëpo kësaj kur i shtohen edhe 154 mijë €, shpenzime për naftë (për ngrohje ), mendoj se ky shpenzim është tepër i madhe duke e pasur parasysh se ky shpenzim, vazhdimisht kemi pasur ankesa se shkollat nuk kanë pasur mundësi të kenë nxehje të mirë ashtu si duhet!

Te kodi 13780, karburante për vetura është prezantuar shpenzim prej 105 mijë e 156 €, por nga raporti i vitit 2012 i prezantuar në seancën e parë të këtij viti nga kryetari i Komunës thuhet se Autoparku ka shpenzuar 50 mijë e 576 litra karburante dhe kur përpjesëtohet me këtë shpenzim del se një litër karburant është paguar 1.079 €. Unë mendoj se këtu diçka nuk qëndron ose është sasia më madhe ose diçka nuk është në rregull, sepse kjo nuk përpjesëtohet në asnjë mënyrë.

Në fund për mua është shumë shqetësuese shuma e borxheve të prezantuara në vlerë diku mbi 3 milion e 300 mijë €. Me këtë politikë qeverisja aktuale e fut Komunën në recesion të thellë për pa dashur për ta bërë asnjë krahasim, por duke u bazuar në trendët e zhvillimit paraprak, mendoj se qytetarët nuk duhet këtë vit të presin asnjë projekt, sepse është obligim për t' u shlyer borxhet.

Ajo që për mua është e paqartë dhe kërkoj një shpjegim prej drejtorit të Zyrës së Prokurimit për të dhënë sqarime si janë krijuar këto borxhe, kur dihet se me Ligjin për prokurim publik, para se të nënshkruhet kontrata me cilin do operator ekonomik fillimisht duhet të zotohen mjetet për atë projekt.

Një fakt dua ta them se në këtë Kuvend e kemi kaluar një projekt shumë ambicioz, për atë pjesën e Kodrës së Dëshmorëve dhe këtu po shoh se është kontraktuar në fillim të vitit 2011, zgjerimi i rrugëve, kurse punët e kryera janë zero? Pse ka ndodhur një gjendje e tillë kërkoj shpjegim?

Arben Maliqi- unë i përshëndes të gjithë, por posaçërisht drejtorin për këtë raport financiar të cilin gjest deri më tash nuk e bërë askush, prandaj është etike që ta përshëndesim, sepse ka bërë një punë të mirë, duke i përshkruar në mënyrë analitike të gjitha gjërat, por a janë mirë apo jo, ju mund ta vëreni?

Gjithashtu e përshëndes kolegun tonë Sami Hoxha i cili ka bërë një punë të shkëlqyer me të cilin si AKR kemi pasur një bashkëpunim solid.

Duhet ta pranojmë dhe ta dimë se së pari duhet t' i dimë mundësitë tona. Ne e dimë se çfarë buxheti kemi, prandaj nuk mund të presim nga kryetari i Komunës me bashkëpunëtorët e tij që t' i realizojë me shkop magjik të gjitha planet. Këtu nuk është fajtor vetëm pozita, por fajtor jemi të gjithë bashkë. Fajtorët më të mëdhenj për mendimin tim dhe jo bashkëpunëtorët tanë janë ata njerëz të cilët i kemi në qendër dhe konkretisht e kam fjalën për deputetët e Kuvendit të Kosovës pa asnjë dallim.

Ata deputet nuk kanë bërë asgjë për Gjilanin dhe nuk i kanë ndihmuar aspak kryetarin të Komunës. Shumë pak ka deputet që e kanë realizuar ndonjë projekt në KK të Gjilanit, por edhe nëse ka filluar diçka ai projekt ka mbetur në gjysmë. Sipas meje këtu qëndron gabimi, sepse ne në Gjilan nuk kemi bashkëpunim në mes vete!

Sa i përket këtij raporti mund të shihni dhe paraprakisht pajtohem me disa gjëra me Zijadinin, por jo për të gjitha, sepse me të vërtetë ne kemi bërë punë të mira në Komunë dhe nuk është çdo gjë e zezë, sepse unë dëgjova vetëm gjëra të zeza. Kemi bërë edhe shumë punë të mira dhe mos ta harrojmë rreth rrotullimin i cili është bërë, është një punë shumë e madhe, mandej mos ta harrojmë ndriçimin pa marrë parasysh se kush e ka financuar dhe disa punë të tjera në qytet. Është e qartë se kemi edhe borxhe, por ne kemi punuar me ato borxhe dhe kemi punuar shumë me ato borxhe, qyteti është rritur. Unë mendoj që së pari duhet t' i kryejmë projektet të cilat janë të papërfunduara dhe mendoj se nuk duhet të fillojmë punë të reja për pa i përfunduar ato projekte.

U bë fjalë edhe për Kosaqën të cilën e përmendi edhe z. Rushiti nga i cili fshat jam edhe unë dhe kjo është një fakt edhe pse unë jam në pozitë nuk po kam mundësi për ta realizuar. Mirëpo kryetari i Komunës i ka punët e tjera dhe nuk i shikon gjërat kush është në pozitë dhe kush në opozitë? Do të thotë edhe pse unë jam nga Kosaqa nuk ka mundur të realizohet asfaltimi i rrugës, por besoj se në të ardhmen besoj se do të kryhet ky asfaltim. Ju lus që të bashkohemi, mos të flasim vetëm për gabime, por të mendojmë për qytetarët tanë, sepse nëse ne nuk kemi bashkëpunim në mes veti dhe nëse nuk i shtyjmë proceset të gjithë së bashku dhe nëse ne nuk punojmë për të mirën e qytetarëve tanë punët tona do të shkojnë vetëm prapa. Kërkoj nga ju të bëjmë trysni të madhe edhe në qendër përmes deputetëve tanë, të krijojmë mundësi dhe kushte sa më të mira për qytetarët e Komunës sonë.

Arianit Sllamniku-u thanë shumë gjëra, por unë po mundohem që këtij raporti dhe këtyre projekteve t' qasem në një formë tjetër, formë e cila ka të bëjë me thithjen e fondeve strukturore të sektorëve të ndryshëm në kuadër të projekteve të BE-së e cila strukturë diku afër 437 milion €, si pasojë e mos qasjes në ato fonde ose mos dijes në qasje në ato fonde janë kthyer prapa.

Sa i përket projekteve thuhet rregullim i shtratit të Lumit Banja, por ai nuk është rregullim i shtratit të atij lumi, por është mbulim i lumit e që është në kuadër të të gjitha shkeljeve të konventave Evropiane. Kjo nuk është qaseje serioze, sepse fondet për të cilat ndahen për sanimin dhe rregullimin e gjendjes në sektorë të ndryshëm. Gjendje dhe rregullim të cilin nuk e kemi parë. Rregullimi i shtratit të Lumit Mirusha ka të bëjë me të njëjtën qasje e që unë kërkoj që ta di rolin e Zyrës për Projekte të Komunës si ekzekutiv në ndërlidhje me Agjencionin për Zhvillim Rajonal. Sa për qind të këtyre projekteve janë përfituar përmes AZHR-së në të mirë të institucioneve të Komunës dhe të qytetarëve, në pjesë dhe sektorë të ndryshëm. Këtu e kemi një listë me zero mundësi të thithjes së atyre fondeve të cilat nuk janë të vogla, por janë disa milionëshe. Ne shtrydhemi me fondin komunal dhe të participimit të qeverisë dhe e ngritëm zërin për deputet që nuk bëjnë presion në Qeveri, kurse ne nuk jemi në gjendje dhe nuk kemi kapacitete për t' i plotësuar kërkesat e Zyrës në aspektin profesional.

Është Zyra e projekteve e cila duhet të jetë, zyre profesionale për thithjen e këtyre fondeve dhe jo vetëm Qeveria dhe buxheti Komunal. Barrën kryesore e banë Zyra e Projekteve e cila ma merr mendja se kalkulimet e saja nuk i ka të mira, sepse një projekt duhet ta ketë fillimin e kontraktimit të punës, përfundimin e tyre dhe alokimin ose sigurimin e vijës buxhetore për atë projekt, por këtë nuk po e shohim!

Ju faleminderit për durimin që patët.

Jashar Jashari- unë do të ndalem pak te shpenzimet kapitale për shëndetësi, sepse në kodin ekonomik 31660 te shpenzimet kapitale me numër rendor 90 pajisje speciale mjekësore thuhet se janë bërë shpenzime kapitale mbi 15 mijë e 900 €. Unë jam kureshtar për ta ditur se për çfarë pajisje mjekësore speciale bëhet fjalë, sepse në raport nuk specifikohen këto shpenzime.

Në kodin tjetër ekonomik 31690 me numër rendor 91 thuhet pajisje të tjera dhe arrin një shumë prej mbi 62 mijë €, prandaj është mirë që të na sqarohet se për çfarë pajisje bëhet fjalë?

Saranda Bllaca- unë e kam një pyetje të shkurtër për kodin ekonomik ku thuhet shërbimet kontraktuese të tjera për dallim nga herëve të tjera kësaj radhe është bërë një specifikim se kush bën pjesë në këtë kod buxhetor dhe shihet se në këtë kod i kemi edhe pagesat e punëtorëve me kontratë në vepër. Pyetja është sa është numri i punëtorëve që punojnë me kontratë në vepër dhe pse ndodh kjo, kur dihet se pagesa prej mallrave dhe shërbimeve nuk është e lejuar me Ligjin mbi buxhetin?

Ibish Ibishi- unë do të flas për projektet e financuara nga grandet për vitin 2012.

Së pari kërkoj që të na epet një sqarim për disa projektet e cilat figurojnë këtu e që thuhet se janë të përfunduara ( mirëpo mund të ketë ndodh ndonjë gabim), prandaj kërkoj sqarim, sepse në raport figurojnë projekte të cilat në terren nuk kanë ndodhur, kurse këtu raportohet se janë projekte të përfunduara.

Tahir Arifi- unë desha shkurtë të them diçka? Sot e kemi raportin financiar dhe do të duhej të koncentrohemi në raportin financiar. Ne e dëgjuam shumë kujdesshëm opozitën

tërë kohën, por mendoj se ia ka huq krejt sot, sepse kanë folur për projektet dhe gjërat e tjera të cilat nuk kanë pasur lidhje raportin financiar dhe do të dëshiroj që t' i konsultoni ekspertët e juaj që i keni brenda grupit.

Sadudin Berisha- ose nuk duhet të kuptosh asgjë ose qëllimisht e bënë për opinione publike këtë politikë. Ne po flasim për raportin financiar për vitin 2012 dhe në detaje u thanë përgjegjësitë të cilat i ka pasur Qeveria Komunale, ato që i ka realizuar dhe ato që nuk i ka realizuar për periudhën jo vetëm të vitit 2012, por nga viti 2009.

Ne dolëm me kërkesa konkrete të detajizuara dhe në të vërtetë është e pajustificueshme mënyra se si heshtet nga pozita për derisa në anën tjetër kur dalim jashtë thuhet se kjo qeverisje është skandaloze nga njerëzit e pozitës!

Nuk dua t' i përmendi emrat se nuk është e ndershme, por për këtë arsyeje kërkoj përgjigje për të gjitha ato shqetësimet tona të cilat janë shumë reale dhe jo vetëm për ne, por edhe për tërë qytetarët e Komunës së Gjilanit. Mos harroni se keni obligime të pakryer për një buxhet komunal të të hyrave vetanake.

Izmi Zeka- në emër të qytetarëve flasin më shumë ata që e kanë pushtetin, sepse ata kanë marrë edhe votën. Po e theksoj se ky raport ka qenë shumë profesional dhe një raport i detalizuar dhe nëse i bëni krahasimet me raportet e juaja kur ju keni qenë në pushtet, ky raport është shumë më i avancuar. Të gjitha informatat që po i kërkon po i merrni si shtesë. Gjendja në qytet ka ndryshuar për të mirë dhe këtë mund ta krahasoni vit pas viti dhe këtë qytetarët e shohin. Mirëpo është edhe një mundësi, sepse edhe gjashtë muaj qytetarët e kanë mundësinë për të parë se kush dhe si është punuar? Unë konsideroj se është bërë një punë e pakrahasueshme me vitet e tjera për të mirë.

Nuhi Nuhiu- unë së pari i falënderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit që kontribuuan dhe i dhanë sugjerimet dhe vërejtjet e tyre. Nga anëtarët e Kuvendit ka shumë pyetje dhe ka pyetje të cilat janë përsëritur, por unë do të mundohem shkurtimisht të jap përgjigje.

Zijadin Malqi bëri pyetje për shpenzimet jashtë vendit, por unë e kam përgatitur një raport prej 400 faqeve dhe nëse dëshironi unë mund të filloj dhe i lexoj të gjitha shpenzimet me radhë faturë për faturë, por i kam të dhënat se kush i ka bërë ato shpenzime dhe kush ka qenë operatorë i cili e ka bërë transportin e atyre udhëtarëve.

Në vijim të fjalës së tij drejtori i lexoi me radhë të gjithë zyrtarët, klubet sportive dhe shoqërive të ndryshme muzikore të cilat kanë udhëtuar jashtë vendit.

Pyetje tjetër furnizimi për zyre ka shumë për të lexuar dhe për të thënë e të cilat drejtori përsëri filloi për t' i lexuar.

Sa përket furnizimit me karburante janë 56 mijë €, kjo është e vërtetë, por kemi pasur obligime të tjera nga viti 2011 në vitin 2012.

Te pastrimi i veturave, ai pastrim bëhet te objekti i kryetarit, punëtori është i angazhuar dhe aty nuk kemi shpenzime.

Te drekat zyrtare, janë zvogëluar, por këtë vit janë zvogëluar edhe më shumë, sepse kemi pasur shpenzime te "Flaka e Janarit", kurse ushqim dhe pije janë pako për rastet sociale që i jep Komuna dhe një pjesë e madhe bëhet nga buxheti i kryetarit dhe për këtë arsyeje i paraqitet kryetarit mallra dhe shërbime një shumë tepër e madhe.

Borxhet e Komunës te kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë të detajizuara, kurse te investimet kapitale, borxhe kemi te shpronësimi. Te operatorët ekonomik i kemi kompanisë "Tali", 145 mijë €, por ajo tash është paguar me 28.1.2013 dhe në këtë pjesë nuk kemi vetëm se te pjesa tjetër te Zyra e Prokurimit.

Lidhur me shpronësimin jeni të njoftuar se shpronësime kem pasur te “Kodra e Dëshmorëve”, Lagjaj e Bllacëve dhe në Qarkore të cilat ende nuk i kemi kompensuar, por janë obligime mbi 1 milion e 350 mijë €.

Sokol Haziri kërkoi që të dihet se cilave kompani i kemi borxh. Borxh i kemi edhe CDI-së, e cila kompani e ka bërë instalimin e ujësjellësit në Zhegër, Poragjë, Ponesh dhe Bresalc dhe kësaj kompanie ia kemi 146 mijë € borxh.

Edhe një operatori i kemi borxh i cili na ka furnizuar me farë të grurit dhe pleh dhe të cilit ia kemi 36 mijë € borxh. Këto janë të gjitha obligimet e të cilat janë të faturuara dhe të papaguara.

Listën e shpronësimit e keni, por kemi mundësi dhe nëse kërkoni ne iu a dërgojmë e cila listë është me emër dhe mbiemër, vendbanim dhe të dhëna të tjera.

Kontratat u kërkuan, por ato e ka për obligim Zyra e Prokurimit, por po theksoj se auditori i përgjithshëm është në Komunë që disa ditë dhe është befasuar se si ne në këtë formë e bëjmë raportin. Në përfundim të fjalës së tij drejtori i dha edhe disa sqarime të tjera, por theksoi se për çdo cent ne mund të raportojmë.

Kontrata në vepër i kemi pasur 10, por tash nuk kemi, sepse e kemi një kompani e cila na jep shërbime.

Lidhur me pyetjen e Jashar Jasharit për shpenzime në shëndetësi, ato janë për autoambulancë dhe karrige stomatologjike.

Pajisje të tjera e kanë problem edhe zyrtarët të cilët po e përgatisin raportin, sepse ka probleme te kodi, sepse nuk janë të specifikuar, kemi pengesa në kode. Kodet nuk i bëjmë ne ato i harton MEF-i.

Lidhur me numrin e kontratave në vepër bëri pyetje Saranda, por do ta keni informatën, por po theksoj se këtë vit janë 10 punëtorë, kurse më parë kanë qenë deri në 30 punëtorë. Ju falënderoj edhe njëherë për kontributin që e dhatë.

Bujar Nevzadi- unë nuk e pata në plan për të diskutuar, por pas diskutimit të anëtarëve të grupit kuvendar të LDK-së jam i detyruar që ta marrë fjalën për t’iu përkujtuar këtyre delegatëve, sepse me siguri kanë harruar, por qytetarët e Gjilanit dhe ne nuk kemi harruar! Ne kemi bashkëpunuar edhe para edhe pas luftës dhe e kam thënë gjatë kohës sa kam qenë në opozitë që të keni kujdes si po veproni dhe punoni dhe çka po vendosni, sepse e leni dosjen dhe gjurmët e prapa!

Mua më nxitoi këshilltarja Bahrie për një kiosk që po e përmend që disa herë, por unë e kam një deklaratë këtu, por kam deklaratë edhe për të tjerët, por këtë po e lexoj shkurtimisht.

Në vijim drejtori i DKA-së e lexoi një deklaratë të qytetarit Isa Muslia i cili kishte pasur një kiosk në oborrin e Shkollës “Abaz Ajeti” i cili e kishte marrë në shfrytëzim nga viti 2000/2001. Mirëpo nga viti 2004/2005 ia kishte bërë pagesën drejtoreshës së shkollës Bahrie Veseli nga 70 € në muaj. Kjo pagesë ka zgjatur derisa ka ardhur në pushtet PDK, përkatësisht është emëruar drejtor i DKA-së Ismail Kurteshi. Në vijim të fjalës drejtori e lexoi në tërësi këtë deklaratë duke theksuar se pas kësaj kohe iu ka ndërprerë pagesa drejtoreshës, sepse ajo nuk ka qenë kompetente.

Gjithashtu iu përkujtoj se në kohën kur ndodhi tërmeti në Gjilan, qytetarët e Gjilanit e dinë se si është menaxhuar kjo ndihmë, por po e theksoj vetëm një rast të qytetarit Muharrem Nevzadi i cili i ka marrë 2 mijë euro ndihmë (armaturë) dhe e ka shit 700 €.

Vetëm një rast e përmenda, prandaj secili duhet ta pastroj oborrin e vetë para këtij Kuvendi, pastaj të japin kritika dhe të bëjnë akuza. Po iu them këshilltarëve të LDK-së të cilët janë të ulur në karrige se kanë bërë uzurpime, po i përmendi punësimet me para, po ia përmendi parat nëpër xhepa dhe po i përmendi dy-tri llogari që ka pasur.

Nuk është e vërtetë se në 100 km, janë shpenzuar 36 litra, këtë mund ta vërtetojmë, kjo nuk qëndron. Goma për vetura private në Dheun e Bardhë po i tregoj Nevzadit, sepse ndoshta ka harruar se kjo ka ndodhur në kohën e Zijadinit kur ka qenë LDK-ja, sepse Dheu i Bardhë ka qenë i tërë asfalt. Në fund po theksoj se nuk ka qytetarë të Gjilanit të cilin nuk e shikojmë në sy, nuk ka qytetarë të Gjilanit që nuk bisedojmë me te dhe jemi të gatshëm për të gjitha të ballafaqohemi. Ju këshilloj që së pari pastroni oborrin e juaj, pastaj dilni para Kuvendit dhe na jepni kritika.

Pas fjalës së drejtorit pati reagime në sallë nga të gjithë anëtarët e grupit kuvendar të LDK-së për ta marrë fjalën, por kjo nuk iu mundësua dhe në shenjë pakënaqësie për mos dhënie të fjalës, grupi kuvendar i LDK-së i lëshoi punimet e seancës dhe nuk u kthyer më në sallë.

Pati kërkesë edhe nga kryetari i Komunës që anëtarët e LDK-së mos ta lëshojnë sallën, por grupi kuvendar i LDK-së përfundimisht doli nga salla, kurse punimet e seancës vazhduan me grupin kuvendar të PDK-së dhe koalicionit dhe të AAK-së.

Qemajl Mustafa- ne ndihemi jashtëzakonisht mirë ashtu edhe si e tha drejtori i DA-së, por edhe unë personalisht ndihem shumë mirë me punën që e kemi bërë këto vite. Është kohë bukur e gjatë, është viti i gjashtë i qeverisjes dhe në Komunë ka rend, ka disiplinë, dihet saktë kush është i pari dhe dihet saktë kush është i fundit. Dihen obligimet dihen përgjegjësitë, ekziston orari i punës, ekziston përshkrimi i vendeve të punës, aktiviteti për secilin dhe secili i kryen punët e veta.

A do të duhej që të jetë edhe më mirë, unë vazhdimisht e kam thënë se ka mundësi të përmirësimit, rritjes së efikasitetit secilën ditë dhe secilin muaj të ardhshëm.

Sa i përket këtij buxheti e kam thënë disa herë dhe nuk është mirë që të keqpërdoret foltorja dhe më vjen keq që grupi i LDK-së doli jashtë, është keqpërdorur kjo hapësirë demokratike e Komunës dhe shoqërisë.

Ky buxhet është buxhet operues, dikush po e quan shpenzues, por shpenzues janë të gjitha buxhetet, sepse buxheti projektohet për t' u shpenzuar. Mirëpo ky është buxhet për të operuar, ose për të mbijetuar me një fjalë. Ju po e shihni se prej atyre 18 milionëve, 11 milion janë paga. Mandej janë 2 milion e më shumë mallra dhe shërbime dhe në këtë mënyrë shumë pak mbetet për zhvillim, por dhe ajo përsëri nuk është zhvillim, sepse atyre që po i themi investime kapitale, nuk janë investime kapitale, por janë pak milion për mirëmbajtje të infrastrukturës ekzistuese. Aty hyjnë mirëmbajtja e rrugëve, dimrit dhe verës, aty është pastrimi i rrugëve, janë shpronësimet, projektimet e ndryshme, planet rregulluese, mirëmbajtja e ndriçimit publik etj. Do të thotë është mirëmbajtje e infrastrukturës ekzistuese, por nuk është buxhet zhvillues.

Këtë duhet ta ketë parasysh secili anëtarë i Kuvendit edhe ai që fare nuk kupton në financa. Buxhetet e komunave tona janë operuese, por jo zhvilluese!

Zhvillimi vjen prej qeverisë, dhuruesve, natyrisht kur Qeveria e ka vullnetin për të investuar në Komunë të caktuara dhe në projekte të caktuara, por dhe dhuruesit nëse gjejnë klimë dhe interes për të investuar. Ne kemi dhurues shumë, por edhe të vlefshëm dhe të vyeshëm e që do të duhej në këto raporte edhe të paraqiten.

Si shembull të tillë e kemi "Gjilani 5", Biblioteka Regjionale, Rezervari i ujit në "Kodrën e Dëshmorëve" i cili është 1.5 milion, mandej Stadiumi i cili fillon nesër, DANIDA, e cila ka bërë investime në Shkollën e Bujqësisë dhe plotë milionë që kanë ardhur nga dhuruesit, por nuk kanë ardhur nga Qeveria? Ne këtë e kemi thënë që plotë dy vite me radhë dhe këto projekte nuk kanë filluar vetëm me dëshirën e kryetarit të Komunës dhe me përcaktim të kryetarit të Komunës, por këto projekte kanë filluar me kërkesën e komunitetit për të pasur infrastrukturë të domosdoshme dhe kanë filluar

natyrisht duke u bazuar në ato trendët zhvillimore të vitit 2008, 2009 e që kanë qenë bukur dinamike, por edhe në zotimet e Qeverisë. Këto projekte kryesisht kanë filluar në këto vite dhe më vonë nuk kemi filluar projekte të reja, sepse unë e di që ne nuk mund të prodhojmë milionë! Për fat të keq këto projekte janë zvarrit, por nuk është shumë brengosëse kjo dhe e vërteta është se ajo që e kemi në raport se obligimet për punët e përfunduara janë të vogla, nuk janë të mëdha, janë 664 mijë €.

Ai obligimi që qëndron atje në shumë prej 5 milion për përmbyllje të gjitha projekteve do të dëshironim për t' i pasur ato para për t' i përmbyll ato projekte, por nëse nuk i kemi arrit deri aty i kemi kryer obligimet dhe kanë mbetur projektet aty ku janë.

Mirëpo a do të duhej kjo për të ndodhë, nuk do të duhej ! E kemi thënë disa herë dhe prapë po e them, por unë marrë pjesën e përgjegjësive vetëm aq sa i takon kryetarin të Komunës dhe këtë përgjegjësi duhet ta marrim të gjithë dhe duhet shtruar pyetjen se ka qenë desh të fillohet me këto projekte apo jo ?

Ne i kemi filluar bazuar në zotimet e kryeministrit të Qeverisë se do ta ndihmojë Komunën me investime në 4 vitet e ardhshme dhe ndoshta kemi gabuar ( unë marrë atë pjesë të përgjegjësive), sepse do të duhej për të pasur të dhënë të prekshme se me të vërtetë do të ndihmohet Komuna dhe pastaj të fillojnë disa projekte të cilat janë më të kushtueshme. Unë po i them se borxhet janë në zvogëlim e sipër dhe tash është fundi i muajit të tretë dhe do ta kemi raportin financiar 3 muajor pas një muaji. Në bazë të dhënave del se mallrat dhe shërbimet kanë ra në 940 mijë, te investimet kapitale u tha ishin 664 mijë €, 230 mijë € janë paga (borxhe), 157 mijë ishin tek komunalit dhe shumë pak pati te subvencionet, mbi 30 mijë €. Të gjitha kur të mblidhen këto janë dy milion, do të thotë prej 3.2 milion sa ishin në fund të vitit të kaluar tash kanë ra në 2 milion.

Ne po vazhdojmë me racionalitet në shpenzime dhe kemi bërë një planifikim shumë më të duhur për vitin 2013 se sa ka qenë në vitin 2012. Për vitin 2012 kemi pasur limitime të skajshme në planifikim të buxhetit. Ishte një palogjikshmëri si përcaktim i MEF-it , atëherë që të mos rritet kodi i mallrave dhe shërbimeve, por përkundrazi tendenca ishte që 10% nga viti në vit të zvogëlohej, por gjithashtu kodi i pagave të mbetet fiks. Kjo nuk funksiononte, sepse organizmi i komunave rritej në vazhdimësi, prandaj duhej prej ndonjë kodi për t' i blerë shërbimet. Mënyrë tjetër nuk ka pasur përveç kodit të mallrave dhe shërbimeve nëse nuk lejohet për të punësuar punëtorë të tjerë.

Neve nuk na është lejuar që ta punësojmë asnjë zyrtarë, por edhe na u tha se shërbimet duhet të privatizohen. Duhet të privatizohet pastrimi i objekteve, duhet privatizuar sigurimin fizik dhe çdo privatizim nënkupton dhënie të parasë edhe më shumë se sa për t' i kompensuar punëtorët. Në 10 punëtorë dalin në një kompani private, atëherë ata kushtojnë më shumë 12-13 e më tepër punëtorë. Shpenzimet te ky kod në të gjitha komunat shpenzimet janë rrit jashtëzakonisht shumë.

Do t' i jap disa sqarime për disa gjëra që i ngritën grupi opozitar dhe ajo rruga e Zabelit, ai zotëria e fragmentarizonte dhe më duket se ai e këtë rrugë e trajtonte prej Qendrës së Zabelit në drejtim të Malishevës. Rruga e Zabelit është emërtuar si rrugë, por ajo shkon prej qendrës deri te Kusca dhe lidhet atje me rrugën e Malishevës. Kemi mbërri deri atje sa një pjesë është finalizuar, kurse pjesa tjetër ka mbet për shkak të disa problemeve pronësore , por ai nuk është problem kryesor, por problem është mbetja pa financa dhe ka mbetur aty!

Derisa ishim në opozitë, unë e kam udhëheq grupin e këshilltarëve të PDK-së dhe e di shumë mirë mënyrën se si janë sjell këta dhe kanë qenë pushtet absolut, sepse i kanë pasur 51% të votave dhe iu siguroj dhe janë të dhënat, janë dosjet që e tha me të drejtë drejtori i Arsimit, kurrë Komuna, prona publike, prona e Komunës nuk është ruajtur më mirë se sa këto 5 vitet e fundit. Unë do të jem njeri shumë i kënaqur nëse një kryetari i



ardhshëm cilido qoftë ai veç e ka këtë vullnet! Të mos e ketë as këtë dije, të mos e ketë ndoshta as këtë vitalitet tonin me këtë strukturë, por vetëm ta ketë këtë vullnet!

Autoparku u përmend, por ne gjithmonë kemi thënë se kurrë nuk ka harxhuar autoparku më shumë 44%, deri në 50 mijë, i afrohet 50 mijë litrave të sasisë së karburanteve brenda vitit. Mesatarja e shpenzimit për 100 km të kaluara është 11.4., 11.7, por të jetë edhe 12, prandaj nuk kemi të bëjmë asgjë me atë 35 litra që e tha dikush. Me këto karikime të kësaj natyre humb ai i cili i plason. Kjo është një karikim i një situatë e cila është larg prej saj, sepse kemi të bëjmë me një shpenzim jashtëzakonisht normal.

Ne duhet të flasim për korrektësinë profesionale edhe teknike të dhënies së një raporti financiar, por disa po orientohen vetëm te investimet kapitale dhe po vazhdon me një luftë të mëhallëve, se nuk është investuar në Zabel, është investuar në Malishevë etj.

Nuk peshohen të gjitha gjërat në kandar, një projekt kushton më shumë, kurse një më pak, por nuk ka hapësirë të Komunës, qoftë në zonë urbane qoftë në fshatra ku nuk kemi bërë investime dhe ato investime e kanë përmirësuar dukshëm jetën e qytetarit, por sidomos e kanë ndalë shpërnguljen për në qytet.

E përmendi dikush se pse vetëm disa kompani marrin projekte? Mirëpo shikoni listat dhe i keni projektet të cilat janë në realizim e sipër? Por shikoni edhe vitet e kaluara projektet të cilat janë realizuar dhe e shihini se nuk ka kompani e cila është e përgatitur teknikisht e profesionalisht në hapësirën e Komunës dhe nuk ka marrë punë. Më falni shumë për infrastrukturën e cila është investuar nga Qeveria, sepse shkollat nuk i kemi tenderuar ne, ato janë tenderuar në Prishtinë. Dhuruesit e kanë mënyrën e vetë të punës dhe ata bëjnë tenderimin me atë mënyrën e tyre dhe i kanë kriteret e veta dhe i japin sipas atyre kriterëve.

U sqarua çështja e kontratave në vepër e të cilat do të jenë për shkak të nevojës për ta mbuluar komunën me shërbime edhe të mjaftueshme edhe kualitative të shtrenjta dhe të sakta. Ne i kemi blerë përmes një agjencioni dhe është më mirë, sepse do të jetë kontratë një vjetore deri në fund të vitit dhe mandej mund të përtërihet, mund të mos përtërihet.

Një pyetje e kam për Arianitin nëse mund t' i tregojë Kuvendit se ku ka marrë këto të dhëna që janë kthyer me qindra milionë për shkak të neglizhencës e të cilat janë destinuar për Kosovën. Do të ishte mirë për të na dhënë sqarime?

Mandej është një manipulim shumë i rëndë kur po e thua se Lumi Banja po mbulohet, por nuk po rregullohet!

Lumi Banja para së gjithash po rregullohet e mandej Lumi Banja po mbulohet dhe në fund do të asfaltohet dhe do të jetë rrugë me një kahe. Unë mund t' i vizatoj edhe elementet të cilat janë investuar atje ( janë elemente të betonit të tipit "U"), shumë të qëndrueshme dhe funksionale, sepse janë projektuar saktë për ta përbirë tërë ujin dhe për të mos vërshuar uji asnjëherë dhe është një nga projektet shumë të mira që po bëhet në qytet.

Ariant Sllamniku- të nderuar kuvendar dhe i respektuar kryetar i Komunës përkundër kërkesës së juaj për shpjegim të këtyre fondeve dhe injorancës të cilën ma bëtë gjatë fjalës sime, por unë prapë iu respektoj, sepse je kryetar i Komunës.

Fondet e BE-së janë të strukturuara, por unë kisha dëshiruar që të më ishte bërë kjo pyetje gjatë mandatit qeverisë prej 2009 e këndeje se si t' ia bëjmë kësaj pune dhe ku janë ato fonde?

Kur them fonde strukturore, janë fonde të cilat shkojnë në bashkëfinancim me BE-në së bashku me Komunën. Ato makinat mjelëse, ato kemi pasur mundësi t' i bëjmë projekt mandej t' i dorëzojmë në grandin e IPA fondeve të Ministrisë së Bujqësisë për t'

i thith ato grande pa asnjë centi të shpenzuar të buxhetit komunal, nëse është shpenzuar, nëse jo është në rregull.

E dyta i keni fondet IPA, mandej TAJEX-i, dhe keni rrugë për t' i përfituar ato vetëm se a keni njohuri?

Qemajl Mustafa- ne me BE-në ne në atë fazën e para marrëveshjeve për stabilizim asocim dhe ne nuk jemi pjesë e asaj marrëveshje. Ne i kemi disa fonde shumë modeste dhe BE investon përmes këtyre AZHR-ve nga pak dhe janë fondet për zonën rurale etj dhe janë këto IPA-t që shkojnë përmes Pushteti Lokal.

Arianit Sllamniku- nënçmimet në aspektin profesional nuk duhet të vijnë prej një ekzekutivi kaq të lartë në nivel të Komunës. Arianit Sllamniku së paku qe 5 vjet e ka si objekt studimi fushën e integritimeve evropiane dhe nëse nuk e ka ditë dikush ta le ta dijë? Unë gjithmonë kam qenë i gatshëm për të dhënë ndihmë në strukturimin e fondeve në të mirë të Komunës, mirëpo nuk e keni desh këtë ndihmë.

Ndërsa sa i përket profesionalizmit, pa keqkuptime dhe me modesti në këtë fushë jam i vetmi.

Izmi Zeka- Zyra e Projekteve e ka kryer punën ashtu si duhet, prandaj duhet parë faktet dhe argumentet, prandaj iu që të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij raporti financiar ?

Aprovohet pika 2/1 e rendit të punës: Raporti financiar për vitin 2012 i Komunës së Gjilanit, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 4 ishin abstenime

2/2- kërkesë për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2011 dhe 2012, në vitin fiskal 2013

Nuhi Nuhiu – është çështja e mjeteve të bartura që nga viti 2012 dhe ne kemi tentuar që ato mjete të barten te kodi i pagave dhe mëditjeve, mirëpo MEF-i e ka kthyer prapa vendimin tonë të mëparshëm, prandaj duhet ta bëjmë shpërndarjen në kodin për shpronësim 136 mijë e 105mijë €, në arsim fillor 51 mijë € dhe në arsimin e mesëm 28 mijë €

Izmi Zeka - së pari duhet anuluar vendimin e seancës së kaluar lidhur me këtë çështje për ridestinim të këtyre mjeteve dhe pastaj e aprovojme vendimin e ri. Kush është për anulim të vendimit të seancës së kaur?

Anulohet vendimi i seancës së kaur me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në seancë.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të pikës 2/2 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/2: kërkesë për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2011 dhe 2012, në vitin fiskal 2013, me të gjitha votat (23) e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në seancë.

Me këto debate seanca në ora 12.45 min i përfundoi punimet

Procesmbajtësi

Kryesuesi i Kuvendit

